



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës  
Opština Priština –Municipality of Prishtina

Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2, shkronja d të Ligjit nr. 03/L – 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008, të nenit 33, paragrafi 33.2, shkronja b, nenit 34, paragrafi 34.1, shkronja d të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 – 391, të dt. 25.02.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 18.03.2022, miratoi këtë

### V E N D I M

#### PËR ANULIMIN E VENDIMIT PËR MIRATIMIN E PLANIT RREGULLUES TË HOLLËSISHËM PËR LAGJEN "KALABRIA"

- I. MIRATOHET Vendimi për anulimin e Vendimit për miratimin e Planit rregullues të hollësishëm për lagjen "Kalabria", me nr. 01-350/05-245432/21, i dt. 12.11.2021.
- II. Sipas pikës I të këtij vendimi, anulimi bëhet për shkak vlerësimit negativ të ligjshmërisë së PRRH-së nga Ministria e Mjedisit, e Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI).
- III. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës dhe Drejtorja e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS  
01-350/01-62828/22, më 21.03.2022

KRYESUESI I KUVENDIT  
Fehmi Kupina

